

VENDIM
Nr. 269, datë 28.4.2023

PËR NJË SHITESË FONDI NË PROGRAMIN “MBËSHTETJE PËR PARTITË POLITIKE”, PËR FINANCIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E VETËQEVERISJES VENDORE TË VITIT 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 88, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe të vendimit nr. 30/2023, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për financimin e fushatës zgjedhore për organet e vetëqeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në programin “Mbështetje për partitë politike” shtohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, i cili u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në këto zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

2. Efekti financiar, i parashikuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama